

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“PANTHER TAXI” SHPK

Neni 1: Emri dhe forma ligjore

Sot më datë 30.04.2025, ne te nenshkruarit:

1. **Erald GUGA** i datëlindjes 08.10.1989, lindur ne Durres dhe banues ne Durres, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi I91008067T

themelojme një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin:

“PANTHER TAXI” SHPK.

Shoqeria rregullon veprimtarine e saj ne perputhje me Aktin e Themelimit, Statutin e saj, me ligjin 9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”

Neni 2: Selia

Selia e shoqërisë do të jetë:

Durres, Lagjia 8, Rruga ”Gani Malushi”, Godinë me Nr. 5

Shoqeria mund të hapë edhe seli të tjera operative, filiale, përfaqësi dhe agjensi në të gjithë territorin e Shqipërise si dhe jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ligjet e vendeve ku ato hapen.

Neni 3: Objekti

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë si më poshtë:

Shërbim taksi për publikun si brenda territorit të Shqipërisë dhe jashtë saj.

Blerja, shitja, tregtimi, marrja dhe dhënia me qira e automjeteve, kullave të karikimit dhe mjeteve të transportit në përgjithësi. Transporti urban dhe interurban në funksion të shërbimit Taxi të udhëtarëve, në përputhje me çdo ligj të zbatueshëm dhe rregulloreve të fushës përkatëse.

Shoqëria mund të kryejë edhe aktivitete të tjera, të marrë pjesë në sipërmarrje të tjera brenda dhe jashtë vendit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 4: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

Neni 5: Kapitali

Kapitali i shoqërisë është 100.000 lekë, i ndarë në 1 kuote. Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:

Erald GUGA është zotërues i 1 kuote, me vlerë 100.000 lekë, me 100% pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë.

Neni 6: Organet drejtuese të shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

(-) Asambleja e Përgjithshme.

(-) Administrator i shoqërisë do të jete **Z. Armalindo Kaso i datëlindjes 10.07.1993, lindur ne Fier dhe banues ne Durres, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi J30710092B për një periudhë 5 - vjeçare me të drejtë riemërimi.**

Neni 7: Viti ushtrimor

Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

Neni 8: Dispozitat e fundit

Shoqëria respekton ligjin dhe statutin që është pjesë e pandarë e këtij akti.

Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKB-në si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Emri dhe nënshkrimi i Ortakut të Shoqërisë

Erald GUGA

ERALD GUGA

